

LIGJ
Nr.7492, datë 8.6.1991

PER DEPARTIZIMIN DHE DEPOLITIZIMIN E DISA ORGANEVE SHTETERORE

Në mbështetje të neneve 6 e 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ndalohet veprimtaria e partive, organizatave a shoqatave politike në repartet, ndërmarrjet e institucionet ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes e të Ministrisë së Rendit Publik, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit, në Ministrinë e Drejtësisë, në prokuroritë, hetuesitë e gjykatat, në plocinë financiare, në aparatet e Kuvendit Popullor, të Presidentit të Republikës e të Këshillit të Ministrave, në ministritë, në organet e barazuara me to e institucionet e tjera qendrore, shëndetësore e arsimore, në ATSH-në e RTSH-në, si dhe në organet lokale të pushtetit e të administratës.

Neni 2

Nuk u lejoheq që të bëjnë pjesë në partitë, organizatat ose shoqatat politike:

Oficerëve, nënoficerëve të shërbimit aktiv dhe punonjësve civilë që janë në marrëdhënie pune me repartet e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore e të Ministrisë së Rendit Publik, si dhe në shkollat e institucionet e tyre, punonjësve të Ministrisë së Punëve të Jashtme e personelit të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë, të gjykatave, të prokurorive e të hetuesive, të policisë financiare, të aparatit të Kuvendit Popullor, të ATSH-së e RTSH-së.

Ky detyrim nuk zbatohet vetëm për personat e zgjedhur deputetë ose anëtarë të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Personat e përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 2, nuk mund të ushtrojnë detyrën e tyre ose të zhvillojnë propagandë në të mirë a në dëm të njëres apo tjetres parti, organizatë ose shoqatë politike. Atyre u ndalohet të marrin pjesë në mbledhje, grumbullime e manifestime të partive, organizatave ose shoqatave politike. Gjatë kryerjes së shërbimit shtetëror ata i nënshtrohen vetëm ligjit dhe janë të detyruar të mbajnë asnjëanësi politike, pavarësisht nga bindjet e vetjake që kanë.

Neni 4

Ushtarët, rezervistët, paraushtarakët e vullnetarët popullorë që janë anëtarë të partive, organizatave a shoqatave politike e shoqërore, gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak ose stërvitjeve, i ndërpresin lidhjet me to, mbajnë asnjëanësi dhe u ndalohet të kryejnë veprimtari ose propagandë partiake.

Ndalohet futja e organizuar e botimeve dhe e shtypit me përmbajtje partiake në repartet

dhe institucionet ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe të Ministrisë së Rendit Publik.

Neni 5

Personat e përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 2, para se të hyjnë në marrëdhënie pune e shërbimi, duhet të paraqesin deklaratë me shkrim, ku të vërtetojnë se nuk marrin pjesë në asnjë parti, organizatë a shoqatë politike. Personat që janë anëtarë të një partie, organizate ose një shoqate politike, duhet të dalin prej tyre brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke bërë me këtë rast deklaratën me shkrim në, të kundërtën lirohen nga shërbimi ose largohen nga puna.

Neni 6

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Mbrojtjes Popullore, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Lartë, ATSH-ja, dhe RTSH-ja të marrin të gjitha masat që procesi i departizimit dhe i depolitizimit të kryhen në mënyrë korrekte pa cënuar veprimtarinë e tyre normale.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA